




LIGJSHMËRIA E PËRFITIMEVE NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS



Prishtinë, mars 2021

Autorët: Lavdim Bajraktari dhe Jeton Hasani

Redaktor: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Mars, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Metodologjia.....	6
3. Mandati ligjor dhe organizimi i Gjykatës Supreme.....	7
4. Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme dhe pagat e tyre.....	9
4.1 Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme.....	9
4.2 Pagat e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme.....	9
5. Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i Gjykatës Supreme.....	10
6. Standardet juridike mbi veprimtarinë, sjelljen dhe shpërblimin monetar të gjyqtarëve.....	13
6.1. Standardet ndërkombëtare.....	13
6.2. Standardet kushtetuese.....	14
6.3. Standardet ligjore.....	16
7. Integriteti dhe shtesat e kontestuara të gjyqtarëve në Supreme.....	17
7.1 Avancimet e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme.....	27
8. Dështimi i AKK-së në zbatimin e ligjit për deklarim të pasurisë.....	28
9. Rekomandime.....	32

1. Përmbledhje ekzekutive

Ndonëse janë ndër zyrtarët publikë më të paguar në Kosovë, kjo si duket nuk i ka mjaftuar një pjese të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Të njëjtit marrin paga mujore nga Buxheti i Kosovës, që shkojnë nga 2,655.00 euro deri në 2,950.00 euro, porse kanë vazhduar që për punë të ndryshme që bëjnë si gjyqtarë, të marrin edhe shtesa, kompensime e mëditje të ndryshme.

Shpeshherë, nga pagesat shtesë që marrin krahas pagës së tyre bazë kalojnë edhe pagën mesatare vjetore që merr një qytetar i Kosovës.

Kompensimet dhe shtesat që gjyqtarët pranojnë nga buxheti që mbushet nga taksapaguesit e Kosovës, në masën më të madhe janë punë që gjyqtarët i kanë bërë gjatë orarit të rregullt të tyre të punës, për të cilën paguhen nga 2,655.00 deri 2,950.00 euro në muaj.

Në rrethana të tilla, kur me taksat e tyre qytetarët i paguajnë gjyqtarët me më shumë se njëzetfishin e pagës minimale në vend, minimumi që publiku pret nga gjyqtarët është që këto paga t'i arsyetojnë duke qenë të përkushtuar në përmbushjen e obligimeve ligjore të paktën në orarin e tyre të rregullt të punës. Një pritje e tillë, legjitime, e qytetarëve duket të jetë larg të qenurit realitet dhe më shumë një iluzion.

Çështja e shpërblimeve të tjera, krahas pagës bazë që marrin zyrtarët publikë, ishte tentuar të adresohet me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Sipas këtij ligji, zyrtarët e lartë të cilët janë anëtar edhe të organeve të institucioneve të tjera publike, nuk kanë të drejtë për shpërblim me pagesë përveç kompensimeve të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to. Qëllimi i këtij ligji ishte të ndalen praktikat kur zyrtarët publik në të njëjtën kohë, gjatë orarit të rregullt të punës të punojnë në një, dy, tre, katër apo edhe më shumë vende të punës. Për më tepër, ky ligj ka përcaktuar edhe kufizimin ku zyrtarët publik të pranojnë kompensime shtesë për punë të tjera zyrtare që kryejnë gjatë orarit të rregullt të punës.

Edhe përkundër se ligji e rregullon këtë fushë në mënyrë shumë të qartë, praktika e dëshmon se gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk kanë dëshmuar lojalitet ndaj ligjit, respekt ndaj vendit të punës dhe profesionit që ushtrojnë.

Në praktikë, pagesat që gjyqtarët kanë vazhduar të marrin për angazhimin në institucione tjera krahas pozitës së gjyqtarit, në shumicën e rasteve tejkalon shumëfish kompensimet e përcaktuara me ligj, apo thënë ndryshe, pagesat që gjyqtarët marrin nga aktivitetet tjera që paguhen nga Buxheti i Kosovës, përkthehen në një pagë të dytë apo edhe të tretë, në kundërshtim më atë që e përcakton apo kufizon ligji për

Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik, ligj i veçantë i cili mbi mbizotëron ndaj ligjeve tjera të aplikueshme.

Krahas pozitive të tyre bazë, një pjesë e madhe e gjyqtarëve mbajnë edhe shumë pozita tjera në organe publike si dhe janë të angazhuar edhe në aktivitete tjera të lejuara jo-publike. Kësisoj, gjyqtarë të caktuar, me pozitat e shumta që mbajnë kanë vendosur të “sfidojnë” edhe ditën 24 orëshe, duke ngritur një pyetje legjitime për publikun, se si këta gjyqtarë arrijnë që brenda të njëjtës kohë, të ushtrojnë në mënyrë profesionale e të ndershme deri në tre apo katër pozita njëherësh.

2. Metodologjia

Instituti i Kosovës për Drejtësi (këtej e tutje: IKD) me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik në lidhje me veprimtarinë profesionale, sjelljen dhe shpërblimet monetare të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, ka përdorur një metodologji të përzier të hulumtimit.

Ky raport i IKD-së është bazuar në të dhënat e siguruar nga dokumente të ndryshme zyrtare, legjislacion primar dhe sekondar, raporte zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave, si dhe të dhënat të siguruar përmes kërkesave për informata dhe qasje në dokumente zyrtare nga institucionet relevante.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe politikat e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor.

Para së gjithash, ky raport është derivat i monitorimit sistematik që IKD i bënë sistemit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe punën e Gjykatës Supreme.

Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka analizuar edhe deklaratimet e pasurisë të të gjithë gjyqtarëve në Gjykatën Supreme. Po ashtu, për hartimin e një raporti sa më të saktë dhe objektiv, IKD ka realizuar edhe intervista me gjyqtarë të Gjykatës Supreme.

Të gjitha gjetjet e monitorimit sistematik grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën analistët juridikë të IKD-së zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e siguruar. Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi reale që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që janë në interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Gjetjet e IKD-së janë trajtuar me anë të analizës së kornizës ligjore, krahasimit të rasteve dhe vendimeve, punës me të dhëna statistikore dhe analizimit të thuktë të çdo veprimi apo vendimi nga sistemi i drejtësisë përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Ky raport përfshinë të dhënat e Gjykatës Supreme për periudhën 2018 - 2020, kurse të dhënat lidhur me të ardhurat e gjyqtarëve përfshijnë vetëm deklaratimin e pasurisë që të njëjtit e kanë bërë në vitin 2020.

3. Mandati ligjor dhe organizimi i Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme shërben si instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë. Juridiksioni i saj shtrihet në gjithë territorin e Kosovës. Në kuadër të kësaj gjykate, funksionojnë edhe Kolegji i Apelit i Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.¹

Gjykata Supreme udhëhiqet nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili emërohet nga Presidenti i Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.² Parimisht, Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji prej tre (3) gjyqtarëve, përveç kur me ligj parashihet ndryshe.

Kompetencat kryesore që kjo gjykatë i ka janë:

- të vendosë lidhur me kërkesat për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë;
- të vendosë lidhur me revizionet, të veprojnë si shkallë e tretë për ankesat e lejuara me ligj, të vendosë lidhur me lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.³


Kompetencë tjetër e Supremes është edhe të përcaktojë qëndrimet parimore, të nxjerrë mendimet juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga të gjitha gjykatat në Kosovë.

Për dallim nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, organizimi i Gjykatës Supreme është më i përgjithshëm. Brenda kësaj gjykate, funksionojnë, **a)** Dega penale; **b)** Dega civile; **c)** Dega administrative dhe **d)** Praktika gjyqësore.

¹ Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat. neni 25.

² Kushtetuta e Kosovës. Neni 103 (4).

³ Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat. neni 26.




Grafika 1: Organizimi i brendshëm i Gjykatës Supreme.

4. Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme dhe pagat e tyre

4.1 Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme gjatë vitit 2020 kishte qenë 16. Kurse numri i gjyqtarëve në Dhomën e Posaçme kishte qenë 15. Si total, numri i gjyqtarëve në këtë Gjykatë kishte qenë 31. Por, gjyqtarë që kishin kryer lëndë kishte qenë për dy më i vogël, apo 29.⁴ Numër i njëjtë i gjyqtarëve në Supreme kishte qenë edhe në vitet 2019 dhe 2018, kurse në Dhomën e Posaçme numri i gjyqtarëve ka qenë më i vogël, përkatësisht 11 në vitin 2019, dhe 13 në vitin 2018.⁵



Grafika 2: Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme gjatë viteve 2018-2020, duke përfshirë edhe gjyqtarët e Dhomës së Posaçme.


4.2 Pagat e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme

Gjyqtarët në Gjykatën Supreme janë ndër zyrtarët publik më të paguar në Kosovë. Paga mujore e kryetarit të Gjykatës Supreme është 2,950.00 euro, kurse ajo e gjyqtarëve 2,655.00 euro.⁶

⁴ Këshilli Gjyqësor i Kosovës. "Raporti Statistikor i Gjykatave vjetor - 2020". (Shih linkun: https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/reports/73409_KGJK_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2010_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf) Qasur për herën e fundit më 16 shkurt 2021.

⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës. "Raporti Statistikor i Gjykatave vjetor - 2019". (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/reports/37650_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2019_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf) Qasur për herën e fundit më 16 shkurt 2020).

⁶ **Shënim:** Lartësia e këtyre pagave bazohet në vendimin nr.4/20, të Qeverisë Haradinaj. (Shih vendimin nr.4/20 të Qeverisë Haradinaj, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_20.pdf) Qasur për herën e fundit 10.02.2021. Ky vendim i Qeverisë Haradinaj ishte shfuqizuar pjesërisht nga vendimi nr.01/02 i Qeverisë Kurti, por, lartësia pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve kishte mbetur sipas vendimit të Qeverisë Haradinaj. (Shih vendimin nr.01/02 (Shih vendimin: [9](https://kryeministri-ks.net/ëp-</p></div><div data-bbox=)



Grafika 3: Paga mujore e kryetarit dhe gjyqtarëve në Gjykatën Supreme.

5. Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i Gjykatës Supreme

Siç u tha edhe më lart, kompetencat e gjyqtarëve në Supreme mund të ndahen në dy kategori: **a)** vendosja lidhur me kërkesat për mjete të jashtëzakonshme, revizionet, ankesat dhe lëndët e Agjencinë Kosovare të Pronës dhe asaj të Privatizimit, dhe **b)** përcaktimi i qëndrimeve parimore duke nxjerrë mendime juridike, udhëzues e buletine për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në Kosovë.

a) Vendosja lidhur me kërkesat për mjete të jashtëzakonshme, revizionet, ankesat dhe lëndët e Agjencinë Kosovare të Pronës dhe asaj të Privatizimit

Në këtë kategori, gjatë vitit 2020 Gjykata Supreme ka qenë më së shumti e ngarkuar me lëndë të revizionit dhe ato të kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë që përbëjnë 70% të totalit të të gjitha lëndëve që ka pasur në punë kjo gjykatë. Sa i përket ngarkesës me lëndë, raportet vjetore të gjykatave i paraqesin Gjykatën Supreme dhe Dhomën e Posaçme si të ndara me njëra tjetrën. Kësisoj, nga këto raporte shihet se ngarkesa me lëndë në Gjykatën Supreme, pa llogaritur Dhomën e Posaçme, është pakrahasimisht më e ulët sesa e instancave më të ulëta gjyqësore.

Në vitin 2020, Gjykata Supreme kishte pasur në punë vetëm 1,580 lëndë. Nga ky numër, 171 lëndë kishin qenë të trashëguara kurse 1,409 lëndë ishin pranuar gjatë vitit 2020. Në fund të vitit, Supremja i kishte përfunduar 1,118 lëndë ndërsa të pazgjidhura i kishin mbetur 392 lëndë. Sipas kësaj, i bie që numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2020 është dyfishuar për dallim nga vitin 2019.⁷

<content/uploads/2020/02/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-2-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>) Qasur për herën e fundit më 10 shkurt 2021).

⁷ Këshilli Gjyqësor i Kosovës. "Raporti Statistikor i Gjykatave vjetor – 2020".

b) Përcaktimi i qëndrimeve parimore duke nxjerrë mendime juridike, udhëzues e buletine për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në Kosovë

Për dallim nga homologët e tyre në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit,¹⁰ gjyqtarët e Gjykatës Supreme kanë treguar rezultate më të mira për sa i përket shfrytëzimit të një kompetence që e kanë instancat më të larta gjyqësore dhe prokuroriale, përkatësisht përcaktimin e qëndrimeve parimore, nxjerrjen e mendimeve juridike e udhëzuesve, të cilat synojnë unifikimin e zbatimit të ligjit nga ana e të gjitha gjykatave në Kosovë dhe shërbimin si udhërrëfyes për gjyqtarët gjatë ushtrimit të punës së tyre.

Në këtë drejtim, Gjykata Supreme në vitin 2018 kishte nxjerrë Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore në Kosovë, kurse gjatë vitit 2019 kishte publikuar edhe katër (4) udhëzues, ndërsa në vitin 2020 pesë (5) udhëzues të tjerë. Gjithashtu, gjatë këtyre tre (3) viteve të fundit, nga Supremja ishin publikuar edhe gjashtë (6) mendime juridike si dhe përmbledhje të vendimeve të kësaj gjykate. Shqetësuese në këtë aspekt mbetet jokohorenca që Supremja në disa raste tregon për veprimet e veta. Këtu vlen të përmendet se Gjykata Supreme kishte vendosur t'i revokojë dy udhëzime të saj vetëm katër (4) muaj pasi i kishte miratuar të njëjtat, veprime të cilat mund të kenë pasoja negative sa i përket sigurisë juridike në vend.¹¹

¹⁰ Shih raportin "*Ligjshmëria e avancimeve dhe përfitimeve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit*". IKD. Shkurt 2021 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ligjshmeria-e-avancimeve-dhe-perfitimeve-ne-zyren-e-kryeprokurorit-te-shtetit/>) Qasur për herën e fundit më 22 shkurt 2021.

¹¹ "*Gjykata Supreme revokon dy udhëzime, miraton draftet e reja*". 4 shkurt 2021. (Shih linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2021/02/04/gjykata-supreme-revokon-dy-udhezime-miraton-draftet-e-reja/>) Qasur për herën e fundit më 16 shkurt 2021.

6. Standardet juridike mbi veprimtarinë, sjelljen dhe shpërblimin monetar të gjyqtarëve

Që të mund të bëhet një vlerësim kuptimplotë i veprimtarisë, sjelljes dhe shpërblimit monetar të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës, së pari duhet të diskutohen standardet juridike të cilat duhet të përshkojnë këto veprimtari, sjellje dhe shpërblime.

Standardet e tilla objektive dhe gjerësisht të pranuar janë të shumta në numër, prandaj ky raport do të kufizohet vetëm në trajtimin e atyre standardeve që kanë relevancë për temën që është objekt raporti. Përkatësisht, do të elaborohen vetëm standardet e përgjithshme dhe normat juridike që kanë të bëjnë me veprimtaritë profesionale të gjyqtarëve që nuk hyjnë në kuadër të funksionit të tyre si gjyqtarë (pajtueshmëria në ushtrimin e funksionit), si dhe me shpërblimet monetare që ndërlidhen me këto veprimtari.

Këto standarde të punës së gjyqtarëve janë shumë domethënëse, për shkak se realizimi i tyre është esencial për jetësimin në praktikë të parimeve dhe vlerave të përgjithshme që duhet të karakterizojnë sistemin gjyqësor në përgjithësi. Po qe se standardet e tilla të sjelljes dhe veprimtarisë profesionale jo-gjyqësore nuk respektohen nga gjyqtarët, atëherë edhe vihet në pikëpyetje pavarësia, paanshmëria e integriteti i gjyqësorit, besueshmëria në sistemin gjyqësor, performanca e duhur në administrimin e drejtësisë, etj., karakteristika këto kyçe për një sistem që mëton të udhëhiqet nga parimi i sundimit të ligjit. Natyrisht, standardet e tilla vlejné edhe për gjyqtarët e Gjykatës Supreme, si autoriteti më i lartë i gjyqësorit të rregullt në Kosovë.

6.1. Standardet ndërkombëtare

Marrë parasysh natyrën e veçantë të funksionit gjyqësor dhe aspiratat e përgjithshme për parandalim të konfliktit të interesit dhe abuzimit të pushtetit, është e vetëkuptueshme që gjyqtarët nuk lejohen të ushtrojnë pa kufizime çfarëdolloj veprimtari apo funksioni profesional krahas atij gjyqësor. Ata nuk guxojnë që gjatë mandatit të tyre të ushtrojnë veprimtari shtesë profesionale të cilat do të cenonin pavarësinë, paanshmërinë, apo integritetin e sistemit gjyqësor.¹² Shumë shtete përcaktojnë normativisht veprimtaritë apo funksionet që janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit. Zakonisht, lejohen vetëm veprimtaritë në sferën edukative, shkencore, artistike, e të ngjashme (në disa shtete vetëm pa shpërblime monetare).¹³

Përgjithësisht, standardet ndërkombëtare nuk ndalojnë një gjyqtar që të merret me shkrime, ligjërime, apo pjesëmarrje në aktivitete që kanë të bëjnë me drejtësinë. Në fakt, gjyqtari është në një pozitë unike që të kontribuojë në avancimin e së drejtës dhe

¹² Consultative Council of European Judges (CCJE), CCJE (2002) Op. N° 3 on the principles and rules governing judges' professional conduct, in particular ethics, incompatible behaviour and impartiality: para. 37.

¹³ Po aty.

përmirësimin e sistemit të drejtësisë, ndaj edhe pjesëmarrja e tij në këto veprimtari është mëse e mirëseardhur. Mirëpo, kjo lejohet me kusht që gjyqtari përkundër këtyre veprimtarive shtesë të vazhdojë me kryerjen e suksesshme të detyrës së tij si gjyqtar, si dhe për aq sa nuk vihet në dyshim paanshmëria dhe pavarësia e tij individuale.¹⁴ Njëherit, standardet ndërkombëtare nuk ndalojnë që një gjyqtar të jetë anëtar i një organi tjetër shtetëror, komisioni, këshilli, e të ngjashme, për aq sa funksioni në atë pozitë, gjithashtu, nuk cenon efikasitetin e gjyqtarit si dhe nuk paraqet rrezik të krijohen dyshime në publik lidhur me pavarësinë apo paanshmërinë e tij. Kuptohet, një gjyqtar nuk mundet të ushtrojë funksione ekzekutive apo legislative gjatë mandatit të tij si gjyqtar.¹⁵

Në anën tjetër, parimisht lejohet që gjyqtarët të marrin shpërblime të arsyeshme për veprimtaritë dhe funksionet tjera që kryejnë, si dhe kanë të drejtën e kompensimit të shpenzimeve që u janë shkaktuar gjatë kryerjes së atyre punëve. Mirëpo, gjyqtarët duhet të kenë kujdes që shpërblimi që ata marrin të mos jetë krahasimisht më i madh sesa ai që marrin personat tjerë jo-gjyqtarë për të njëjtën punë apo funksion, në mënyrë që të mos shfrytëzohet pozita e gjyqtarës për beneficione shtesë. Njëherit, gjyqtari/ja duhet të ketë kujdes që veprimtaria apo funksioni shtesë që ajo bën të mos krijojë përshtypjen tek një person i arsyeshëm se po bëhet vetëm sa për të rritur pasurinë e tij/saj. Gjyqësori supozohet të shërbejë në të mirë të qytetarëve, e jo si një segment i ekonomisë konkurruese të tregut.¹⁶ Sjelljet në kundërshtim me këtë standard, mes tjerash, zbehin edhe besueshmërinë e qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Në fund, sigurisht që çdo shpërblim i pranuar duhet edhe të jetë në pajtueshmëri me normat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Krahas këtyre standardeve të përgjithshme minimale, shtetet dallojnë shumë në atë se sa konkretisht janë strikte në raport me papajtueshmërinë e funksionit gjyqësor me veprimtaritë tjera dhe në rregullat për shpërblime monetare lidhur me këto veprimtari apo funksione. Siç do të shihet në vijim, Kosova bën pjesë në shtetet relativisht strikte.

6.2. Standardet kushtetuese

Kushtetuta e Kosovës nuk rregullon çështjen e shpërblimeve monetare për gjyqësorin, por vetëm papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve tjera njëkohësisht me atë të gjyqtarit. Në këtë çështje, Kushtetuta e Kosovës, e cila gëzon supremacinë normative në vend, është më strikte sesa standardet ndërkombëtare ku ndër të tjera thekson se:

¹⁴ Shih "Bangalore Principles of Judicial Conduct (2002)": para. 4.11. Shih gjithashtu "United Nations Office on Drugs and Crime, *Commentary on The Bangalore Principles of Judicial Conduct (2007)*": para. 156-7.

¹⁵ United Nations, *Commentary*, para. 164.

¹⁶ Po aty. para. 195.

1. Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj.
2. Gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit.

Pra, konform kësaj dispozite kushtetuese, mes tjerash, një gjyqtar nuk mundet të ushtrojë asnjë funksion në institucione tjera shtetërore, po qe se ato institucione shtetërore nuk hyjnë nën ombrellën e pushtetit gjyqësor. Këtu kihet parasysh veçanërisht ndalimi i gjyqtarëve që të ushtrojnë funksione që dirigjohen nga pushtetet tjera shtetërore, përkatësisht ekzekutivi dhe legjislativi (ndërkaq është diskutabile se a vlen e njëjta ndalesë kushtetuese edhe për funksione në institucionet shtetërore të pavarura, si p.sh. Akademinë e Drejtësisë, ku kryetari i Gjykatës Supreme *ex officio* është edhe anëtar i Këshillit Drejtues).

Tek gjyqtarët e Gjykatës Supreme, vërehet se disa nga ta në fakt ushtrojnë funksione që qartazi nuk hyjnë nën autoritetin e pushtetit gjyqësor. Kështu, disa nga gjyqtarët e Supremes janë të angazhuar si ekzaminues në Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, i cili provim gjendet tërësisht nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë. Disa gjyqtarë tjerë janë të angazhuar në komisione qeveritare, siç është ai për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Është fakt që një gjyqtar i Supremes duhet *ex lege* të jetë kryesues i këtij Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit përmes ligjit përkatës¹⁷ – përkundër Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, ku nuk ekziston një përcaktim i tillë përmes ligjit, por kjo nuk e liron gjyqtarin nga obligimi *kushtetues* që të mos ushtrojë funksione në institucione jashtë gjyqësorit. Duke qenë se në hierarkinë normative Kushtetuta qëndron padyshim më lart se ligji, këta gjyqtarë nuk do duhej të merrnin pjesë në komisione të tilla, për aq sa ato gjenden nën administrim të pushteteve tjera e jo gjyqësorit (të paktën pjesërisht). Edhe në qoftë se për arsyet më fisnike gjyqtarët do vendosnin të merrnin pjesë në këto komisione, atëherë të paktën nuk do duhej të pranonin shpërblime monetare për punën e kryer. Vetëm pse një ligj përcakton se një gjyqtar duhet të jetë anëtar i një institucioni, komisioni, apo këshilli të caktuar jashtë gjyqësorit, kjo nuk e obligon Këshillin Gjyqësor e as ndonjë gjyqtar që të veprojë drejt realizimit të asaj kërkesë ligjore, kur ndalesa kushtetuese është e qartë. Në vend të kësaj, Këshilli Gjyqësor do duhej të lobonte që institucionet jashtë gjyqësorit që kanë të bëjnë me drejtësi, e që shprehin dëshirë ose e shohin të nevojshme të kenë në mesin e tyre gjyqtarë, të futen (të paktën pjesërisht) nën ombrellën e pushtetit gjyqësor përmes ligjit. Kuptohet, kjo ndalesë kushtetuese nuk vlen për ato pozita apo funksione të cilat gjenden jashtë

¹⁷ Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

gjqësorit e që vet Kushtetuta i parasheh të kryhen nga ana e ndonjë gjyqtari. I tillë është rasti vetëm me funksionin e Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6.3. Standardet ligjore

Sipas kornizës ligjore të Kosovës, gjyqtarëve u lejohet të merren me veprimtari profesionale jashtë funksionit të tyre si gjyqtarë, mirëpo me kufizime të caktuara. Përkatësisht, Ligji për Gjykatat parasheh se gjyqtarët, me aprovim të Këshillit Gjyqësor, *“kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore”* me kusht që këto organizata e takime të jenë të atilla që të *“promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.”* Njëherit, gjyqtarët mund të angazhohen edhe në veprimtari tjera por vetëm jashtë orarit të punës, me kusht që këto veprimtari të jenë në pajtueshmëri me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Sipas këtij Kodi, këto veprimtari jashtë orarit lejohen vetëm po qe se ato *“nuk e vënë në pikëpyetje efikasitetin, performancën si dhe ushtrimin e rregullt dhe të drejtë të funksionit të gjyqtarit.”*¹⁸ Për këto veprimtari profesionale jo-gjyqësore, sipas Ligjit për Gjykatat, gjyqtarët kanë të drejtë në shpërblim i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej 25% të pagës bazë. Rrjedhimisht, sipas legjislacionit vendor, për veprimtaritë profesionale jo-gjyqësore të kryera brenda orarit të rregullt të punës, *a contrario*, nuk parashihet ndonjë shpërblim për gjyqtarët—përveç nëse këto veprimtari kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në *“organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.”* Përkundër kësaj, shumë gjyqtarë të Gjykatës Supreme krahas pagës së tyre bazë pranojnë shpërblime monetare shtesë edhe për punë jo-gjyqësore që kryejnë gjatë orarit të tyre të punës si gjyqtarë, siç është rasti me gjyqtarët trajnues në Akademinë e Drejtësisë, gjyqtarët anëtarë të komisioneve brenda e jashtë gjyqësorit, gjyqtarët anëtarë të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, etj. Të gjitha këto veprimtari nuk mund të interpretohet se hyjnë nën kategorinë ligjore të *“pjesëmarrjes në organizata profesionale të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.”* Rrjedhimisht, nuk ka bazë ligjore që për këto veprimtari gjyqtarët të kenë shpërblime shtesë—për aq sa këto veprimtari bëhen brenda orarit të rregullt të punës.

Në anën tjetër, në raste të caktuara gjyqtarët nuk lejohet të pranojnë shpërblime shtesë edhe për veprimtaritë që kryejnë jashtë orarit të rregullt të punës. Kjo pasi që Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit parasheh si në vijim:

Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të

¹⁸ Neni 4.8 i Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.

Pra, një gjyqtar mund të jetë anëtar i më së shumti një organi të çfarëdo institucioni publik, përveç nëse ligjet përcaktojnë se një zyrtar i lartë do të jetë *ex officio* edhe anëtar i ndonjë institucioni tjetër. Mirëpo, në çdo rast, gjyqtari nuk ka të drejtë në shpërblime shtesë (por vetëm në kompensim të shpenzimeve). Kështu, një dispozitë e tillë e bën të parregullt, për shembull, shpërblimin monetar që merr Kryetari i Gjykatës Supreme si anëtar *ex officio* i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.

7. Integriteti dhe shtesat e kontestuara të gjyqtarëve në Supreme

Përkundër faktit se janë ndër zyrtarët publikë më të paguar në vend, siç duket një pjesë të gjyqtarëve të Supremes nuk u ka mjaftuar paga që ata marrin nga Buxheti i Kosovës. Kësisoj, të njëjtit krahas pagave të majme që marrin si gjyqtarë, kanë vazhduar që të realizojnë edhe të ardhura tjera nga kompensimet, mëditjet e pagesa për punë që në shumicën e rasteve i kryejnë gjatë orarit të rregullt të punës që ata kanë.

Të gjitha këto të ardhura, këta gjyqtarë i kanë marrë nga Buxheti i Kosovës. Përveç kësaj, një pjesë e gjyqtarëve kanë realizuar të ardhura edhe nga veprimtari tjera që u lejohen me ligj, qoftë nga angazhimet si profesorë e ligjërues, e deri tek angazhimet si ekspertë në hartimin e komentareve të ndryshëm.

Me pagat mujore nga 2,655.00 euro për gjyqtarë e deri tek paga prej 2,955.00 euro për kryetarin e Gjykatës Supreme, secili qytetar dhe taksapagues pret nga këta zyrtar publikë t'i arsyetojnë këto të hyra duke ushtruar funksionin gjyqësor të paktën gjatë orarit të rregullt të punës. Por, në praktikë, shumë nga këta gjyqtarë, gjatë orarit të rregullt të punës, janë angazhuar edhe në punë të tjera jo-gjyqësore. E për këto angazhime, gjyqtarët kanë realizuar të ardhura shtesë, paçka se në këtë kohë kur gjyqtarët ishin angazhuar në punë tjera dhe nuk kishin qenë në vendet e tyre të punës, të njëjtit kishin vazhduar të realizojnë edhe pagën e tyre bazë të gjyqtarit.

Çështja e shtesave dhe kompensimeve të tjera ishte tentuar të adresohet përmes Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Në këtë Ligj, zyrtarëve të lartë, që përfshin edhe gjyqtarët, u ishte ndaluar të jenë pjesë e më shumë se një organi drejtues të organeve të institucioneve publike, përveç se kur parashihet ndryshe me ligj, porse, i njëjti Ligj kishte përcaktuar se zyrtarët e lartë nuk kanë të drejtë shpërblimi me pagesë për këto funksione, përjashtimisht të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.¹⁹

¹⁹ Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, **nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë**, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të”.

Neni 13.2 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Lidhur me kufizimet që përcakton Ligji për Parandalimin e Konflikt të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, në mbajtjen e më shumë se sa një pozitë në organe të institucioneve publike dhe shpërblimeve me pagesë për punën në këto organe, me kërkesë të IKD, Ministria e Drejtësisë si sponsorizuese e ligjit në fjalë, në shkurt 2020, kishte nxjerrë edhe një opinion ligjor lidhur me interpretimin e neneve 12 dhe 13 të ligjit të lartcekur, ku ishin riafirmuar ato që thuhën në ligj.²⁰

Po ashtu, lidhur me këtë, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi”, ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ardian Bajraktari, kishte thënë se dispozitat e këtij ligjit, për ta si sponsorizues të ligjit janë të qarta dhe eksplicite kur ndalojnë ushtrimin e më shumë se sa një pozite udhëheqëse krahas ushtrimit dhe funksionit të lartë publik, përjashtimisht rasteve kur në mënyrë eksplicite parashihet me ligj, dhe se po ashtu, sipas tij, në mënyrën eksplicite ligji ndalon edhe kompensimin për angazhime gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare edhe angazhimin në ndonjë komision tjetër, përjashtimisht çështjes kompensimit që ndërlidhen me shpenzimet e udhëtimeve dhe shpenzimeve tjera që siç mund të jenë dreka ose të ngjashme.²¹

Gjithashtu, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ministri i atëhershëm i Drejtësisë, Abelard Tahiri, si sponsorizues i ligjit, kishte thënë për “Betimi për Drejtësi” se me anë të këtij ligji do të stopohet praktika e “supermenëve” që mbajnë shumë pozita si dhe buxhetit të shtetit do t’i kursehen miliona euro nga shtesat e ndryshme që ishin paguar zyrtarët.²²

Ajo çka ka ndodhur realisht në praktikë është që gjyqtarët kanë vazhduar të shpërblehen me shtesa të ndryshme, përveç pagave të tyre si gjyqtarë. Krahas punës

²⁰ Opinion Ligjor i nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë. Nr.41/20. 26 shkurt 2020.

²¹ Shih emisionin me “Abuzimet me pozita dhe shtesa në kundërshtim me ligjin”. Betimi për Drejtësi. 27 shkurt 2021 (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=rjRfDXGMO-I>) Qasur për herën e fundit më 2 mars 2021.

²² Shih intervistën me ish-ministrin Abelard Tahiri. 13 tetor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/interviste-abelard-tahiri-2/>) Qasur për herën e fundit më 1 mars 2021.

së tyre si gjyqtarë, gjyqtarët e Supremes del se janë të angazhuar edhe deri në tre apo më shumë funksione. Të dhënat e poshtëshënuara janë marrë nga deklaratimet e pasurisë që gjyqtarët kanë bërë në Agjencinë Kundër Korrupsion dhe intervistat e realizuara me disa nga gjyqtarët.

i) Enver Peci

Përveç pozitës së Kryetarit të Gjykatës Supreme, z. Peci në deklaratimin e pasurisë që ka bërë në vitin 2020, ka deklaruar se ka ushtruar edhe dy pozita tjera, atë të anëtarit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë si dhe të anëtarit të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

Në këtë deklaratimin të tij të pasurisë, z. Peci ka treguar se ka realizuar vetëm nga paga 35,585.70 euro. Po ashtu, i njëjti del se ka realizuar edhe 1,290.80 euro të tjera nga takimet që janë mbajtur në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe 3,083.04 euro pagesa si anëtar i Komisionit për Dhënie të Provimit të Jurisprudencës. Bashkë me shtesa dhe mëditje tjera të deklaruara, del se z. Peci sipas deklaratimit të tij të pasurisë ka realizuar 43 820,00 euro brenda vitit.

Lidhur me shpërblimet me pagesë të pranuar nga puna e tij në Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës dhe të Këshillit Drejtues të Akademisë të Drejtësisë, z. Peci është thirrur në ligjet që ishin miratuar para se të hyjë në fuqi Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Konkretisht, z. Peci, në një përgjigje për IKD-në, ka deklaruar se pagesat nga Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës i ka pranuar duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit Për Provimin e Jurisprudencës. Kurse, për pagesat që i kishte marrë nga Akademia e Drejtësisë, z. Peci thotë se të njëjtat i kishte pranuar duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.²³

Sa i përket funksionit që z. Peci ushtron në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës si ekzaminues, siç edhe është elaboruar më lart në nënkapitullin 6.2, një gjë e tillë atij nuk i lejohej. Kjo pasi që Kushtetuta parasheh shprehimisht që një gjyqtar “nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit” (neni 106). Duke qenë se i tërë Provimi i Jurisprudencës administrohet nga Ministria e Drejtësisë e aspak nga gjyqësori, z. Peci e ushtron këtë funksion pa të drejtë, siç është i padrejtë edhe shpërblimi monetar që e merr me ushtrimin e këtij funksioni (3,083.04 euro).

Pastaj, siç edhe është përmendur më lart edhe në nënkapitullin 6.3, z. Peci pa të drejtë merr shpërblim monetar nga funksioni i tij si anëtar *ex officio* i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë. Megjithatë Ligji për Akademinë e Drejtësisë ia njeh anëtarit të Këshillit Drejtues të drejtën në shpërblim, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ndalon çfarëdo shpërblimi në rastet kur zyrtari i lartë është edhe anëtar i një

²³ Përgjigje e z. Peci për IKD. 22 shkurt 2021.

organi drejtues të institucionit publik (neni 13(2)). Si ligj i mëvonshëm, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka përparësi. Ndaj edhe z. Peci nuk do duhej të pranonte shpërblim për funksionin që kryen në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.

ii) Agim Maliqi

Gjyqtari tjetër i Supremes, z. Agim Maliqi, në deklarin e tij të pasurisë ka theksuar se krahas punës së tij si gjyqtar ka qenë i angazhuar edhe si trajnues në Akademinë e Drejtësisë, anëtar i grupit punues në projektin TIK-SMIL dhe komisioner për mbikëqyrjen e procesit të përgjimeve të komunikimeve elektronike.

Si pagë bazë bashkë me mëditje, z.Maliqi del se ka realizuar shumën prej 32,826,17 euro, ndërsa nga trajnimet në Akademinë e Drejtësisë, ka realizuar edhe 1,410.75 euro tjera. Por, mënyra se si e ka deklaruar pasurinë e tij z. Maliqi nuk është konform Ligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lart publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Ky Ligj, në nenin 5.3 të tij, ka përcaktuar ndër të tjera se *“Në deklaratën për pasurinë e të ardhurave dhe detyrimeve financiare, zyrtari i lartë publik cek shumën, llojin dhe burimin e SECILËS të ardhur...”*. Në mënyrën se si është deklaruar pasuria nga z. Maliqi, është e pamundur për publikun të kuptojë se sa nga të ardhurat e tij janë nga paga bazë e sa të tjera janë realizuar nga shtesat e mëditjet tjera.

Lidhur me të ardhurat që kishte pranuar nga Akademia e Drejtësisë, z. Maliqi është thirrur në Ligjin për Akademinë për Drejtësinë, i cili përcakton se trajnuesit kanë të drejtë për kompensim. Kurse, sa i përket mënyrës së deklarimit të të hyrave të tij, z. Maliqi insiston se të njëjtat janë deklaruar sipas ligjit, ku thekson se shumata totale e të ardhurave përfshin pagën dhe mëditjet që rrjedhin nga pozita e Komisionerit për përgjime elektronike dhe të udhëtimeve. Mirëpo, siç shihet edhe nga deklarimi i pasurisë dhe nga përgjigja që ka dhënë për IKD, taksapaguesi kosovar e ka të pamundshme të identifikojë se sa ka qenë paga e z. Maliqit si gjyqtar, e sa kanë qenë shtesat që i njëjti i ka marrë. Në këtë rast, z. Maliqi as në deklarin e tij të pasurisë e as në përgjigjen për IKD nuk ka bërë dallimin mes pagës dhe mëditjeve si dy llojeve të ndryshme të të ardhurave.²⁴

Njëherit, siç edhe është përmendur në nënkapitullin 6.3, gjyqtarët nuk kanë të drejtë të pranojnë shpërblime shtesë po qe se ata veprimtarinë e trajnuesit në Akademi të Drejtësisë e ushtrojnë gjatë orarit të tyre të punës. Nuk kemi të dhëna nëse z. Maliqi e ushtron këtë funksion gjatë apo pas orarit të punës. Mirëpo, Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë sugjeron që është praktikë e zakonshme që gjyqtarët të jenë trajnues në

²⁴ Përgjigje e z. Maliqit për IKD. 22 shkurt 2021.

Akademi të Drejtësisë gjatë orarit të tyre të punës.²⁵ E njëjta vlen edhe për funksionin e z. Maliqi si komisioner për mbikëqyrjen e procesit të përgjimeve të komunikimeve elektronike: nëse ky funksion ushtrohet gjatë orarit të punës, nuk duhet të paguhet (shih për më shumë 6.3).

iii) Albert Zogaj

Gjyqtari Albert Zogaj, në deklarin e tij të pasurisë ka treguar se përveç pozitës së gjyqtarit, është edhe ligjërues në Kolegjin AAB. Po ashtu, gjatë vitit 2019, z. Zogaj ka qenë edhe pjesë e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Si pagë vjetore, z. Zogaj ka deklaruar shumën prej 26,303.41 euro, që paraqet pagën e tij si gjyqtar i Apelit në kohën e deklarin të pasurisë. Nga kolegji AAB, z. Zogaj ka deklaruar 5,472.00 euro të ardhura, kurse, 6,935.29 euro të ardhura tjera i kishte deklaruar nga KGJK, Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, Akademia e Drejtësisë dhe angazhime të tjera. Këto të fundit, z. Zogaj nuk i kishte ndarë sipas shumës, llojit apo burimit të tyre, siç kërkohet me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, por të gjitha bashkë i kishte deklaruar në një rubrikë. Si total, z. Zogaj kishte deklaruar të ardhura vjetore prej 38,710.00 euro. Lidhur me këto të hyra shtesë që kishte realizuar krahas pagës bazë, gjyqtari Zogaj ka theksuar se të njëjtat i ka deklaruar konform ligjit.²⁶ Më 26 janar 2021, KGJK kishte nxjerrë një vendim me të cilin, z. Zogaj i kishte lejuar të angazhohet si konsulent i pavarur në projektin e organizatës jo-qeveritare "Inject". Në këtë pozitë, sipas vendimit të KGJK-së, gjyqtari Zogaj do të qëndrojë për një periudhë pesë mujore ndërsa do të paguhet nga 506,40 cent, apo në total 2,532.00 euro.

Sa i përket funksionit të z. Zogaj në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës, një funksion i tillë atij nuk i lejohet, për shkak të rrethanave të elaboruara më lart kur flitet për gjyqtarin Enver Peci.

Sa i përket të hyrave të palejueshme që z. Zogaj i realizon si trajnues në Akademi të Drejtësisë, vlejné po ashtu argumentet që elaborohen më lart kur flitet për gjyqtarin Agim Maliqi.

iv) Fejzullah Rexhepi

Një gjyqtar tjetër që ishte avancuar në Supreme gjatë vitit 2020, sikurse gjyqtari Zogaj, është z. Fejzullah Rexhepi. Ky i fundit, në deklarin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte deklaruar se krahas pozitës së gjyqtarit mban pozitën edhe të anëtarit në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) si dhe është trajnues në Akademinë e Drejtësisë. Si pagë vjetore prej gjyqtari, z. Rexhepi kishte deklaruar

²⁵ Shih pikën 4.8 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

²⁶ Përgjigje e z. Zogaj për IKD. 22 shkurt 2021.

26,538,02 euro, kurse si pagë nga PZAP kishte deklaruar 6,192,76 euro. 889 euro të tjera, z. Rexhepi i kishte deklaruar si mëditje nga Akademia e Drejtësisë dhe 88 euro nga KGJK, ashtu që si të ardhura totale vjetore, 33,697.00 euro.

Lidhur me këto të hyra, gjyqtari Rexhepi ka theksuar se të njëjtat i ka deklaruar konform ligjit.²⁷

Siç edhe elaborohet në kapitullin 6 të këtij raporti, një gjyqtar që është anëtar në PZAP nuk lejohet të ketë shpërblime shtesë po qe se funksioni i tij në PZAP ushtrohet gjatë orarit të punës si gjyqtar (shih kapitullin 6.3). Në këtë rast, gjithashtu është e rëndësishme të ceket se sipas Ligjit për Zgjedhje, konkretisht nenit 116.2, anëtarët e PZAP-it, në një periudhë prej 60 ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtar të PZAP-it. Rrjedhimisht, në këtë kohë, del se për z.Rexhepi dhe gjyqtarët tjerë të PZAP-it puna e tyre si gjyqtarë në gjykatat ku ata shërbejnë bëhet dytësore. Por, përkundër kësaj, z.Rexhepi dhe gjyqtarët tjerë të PZAP-it vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre të plota si gjyqtarë, ndërsa, përveç këtyre, ata shpërblehen edhe me të ardhura nga PZAP që tejkalojnë edhe pagat mesatare vjetore të qytetarëve të Kosovës.

Sa i përket të hyrave të palejueshme që z. Rexhepi i realizon si trajnues në Akademi të Drejtësisë gjatë orarit të rregullt të punës, vlejnë po ashtu argumentet që elaborohen më lart kur flitet për gjyqtarin Agim Maliqi (dhe në nënkapitullin 6.3).

v) Gyltene Sylejmani

Gjyqtarja Gyltene Sylejmani ka deklaruar në vitin 2020, se krahas pozitës së saj si gjyqtare e njëjta është edhe anëtare e PZAP-it dhe e komisionit për vlerësim të performancës në KGJK. Të ardhura nga paga dhe nga shtesat për komisione, gjyqtarja Sylejmani ka deklaruar 39,488.11 euro. Këto të hyra, znj. Sylejmani nuk i ka ndarë sipas shumës dhe llojit të tyre, por i ka paraqitur bashkë. Po ashtu, znj. Sylejmani ka deklaruar se ka pranuar kompensime nga PZAP, shumën prej 6,778.15 euro. Si total, të ardhura vjetore, znj. Sylejmani ka deklaruar se ka pasur 46,266.00 euro. Lidhur me të hyrat shtesë që kishte pranuar nga PZAP, znj. Sylejmani ka thënë se të njëjtat i ka pranuar në bazë Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhje.²⁸

Sa i përket palejueshmërisë së pranimit të shpërblimeve shtesë të znj. Sylejmani nga funksioni i saj në PZAP, vlejnë njësoj komentet e dhëna më lart tek gjyqtari Fejzullah Rexhepi. Njësoj të palejueshme janë edhe shpërblimet shtesë që ajo merr nga funksioni i saj si anëtare e komisionit në KGJK, po qe se ai ushtrohet gjatë orarit të rregullt të punës, siç edhe është elaboruar në nënkapitullin 6.3.

²⁷ Përgjigje e z. Rexhepi për IKD. 22 shkurt 2021.

²⁸ Përgjigje e znj. Sylejmani për IKD. 22 shkurt 2021.

vi) Nebojša Boričić

Gjyqtari Boričić ka deklaruar në vitin 2020, se përveç pozitës së gjyqtarit, ka qenë edhe pjesë e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës si dhe anëtar i bordit editorial të gazetës "Justicia". Si pagë bazë, z. Boričić ka deklaruar të ardhura prej 31,152.38 euro, kurse nga Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës ka deklaruar të ardhura prej 3,528.00 euro. Bashkë me disa mëditje tjera të vogla, z. Boričić ka deklaruar të ardhura totale vjetore prej 35,379.00 euro.

Të hyrat shtesë që kishte realizuar nga puna e tij në Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, z. Boričić ka thënë se i ka realizuar duke u thirrur në Ligjin nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës.

Për të njëjtat arsye të dhëna në rastin e gjyqtarit Enver Peci dhe Albert Zogaj, gjyqtari Nebojša Boričić është e papajtueshme të jetë edhe anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, e aq më pak të pranojë shpërblime shtesë.

vii) Nesrin Lushta

Gjyqtarja Nesrin Lushta, në deklarimin e saj të pasurisë në vitin 2020, ka theksuar se përveç pozitës së gjyqtares, ushtron edhe pozitën e Kryetares së Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimin si dhe po ashtu është anëtare e Komisionit për vlerësim të performancës së gjyqtarëve dhe trajnuese në Akademinë e Drejtësisë.

Të ardhurat e saj vjetore, znj. Lushta i ka deklaruar duke mos i ndarë të gjitha ato sipas shumës dhe llojit të të ardhurave siç kërkohet me ligj. Me këtë rast, znj. Lushta ka deklaruar të ardhura prej 33,480.02 euro nga paga bazë dhe nga kompensimet si anëtare e komisionit në KGJK. Gjithashtu, znj. Lushta ka deklaruar edhe 3,334.50 euro si kryetare e Komisionit për kompensim të viktimave dhe 1,282.05 euro nga Akademia e Drejtësisë. Bashkë edhe me disa mëditje për udhëtime zyrtare, znj. Lushta ka deklaruar të ardhura vjetore prej 38,174.00 euro.

Lidhur me pagesat e pranuar nga puna e saj në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimin dhe nga Akademia e Drejtësisë, znj. Lushta, në një përgjigje për IKD ka deklaruar se ato të ardhura i ka pranuar duke u bazuar në nenin 25.par.2.të Ligjit nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 25.par.3.të Ligjit nr.05/L-036 Për Kompensimin e Viktimave të Krimin. Sipas përgjigjes së saj, këto të ardhura, janë në pajtim me Kodin e Etikës Profesionale Për Gjyqtarë.²⁹

Duke qenë se Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimin funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, konform kërkesave kushtetuese të elaboruara në

²⁹ Përgjigje e znj. Lushta për IKD. 22 shkurt 2021.

nënkapitullin 6.2, znj. Lushta nuk do duhej të ushtronte këtë funksion. Aq më pak të pranonte të hyra nga i njëjti.

Sa i përket palejueshmërisë së pranimi të shpërblimeve shtesë në Komisionin për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, vlejné argumentet e njëjta të dhëna në rastin e gjyqtarës Gyltene Sylejmani.

Sa i përket shpërblimeve shtesë për shkak të trajnimeve të mbajtura në Akademinë e Drejtësisë, për znj. Lushta vlejné të njëjtat komente të dhëna gjetiu për gjyqtarët trajnues në AD (shih nënkapitullin 6.3 dhe komentet për gjyqtarin Agim Maliqi).

viii) Shukri Sylejmani

Në deklarin e pasurisë që kishte bërë në vitin 2020, gjyqtari Shukri Sylejmani kishte deklaruar se krahas pozitës së gjyqtarit, ushtron edhe tri (3) funksione tjera: atë të kryesuesit të Komisionit për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, trajnues në Akademinë e Drejtësisë dhe anëtar i Komisionit për Rishqyrtim në KGJK. Po ashtu, nga viti 2020 e tutje, z. Sylejmani mban edhe pozitën e kryesuesit në PZAP.

Si të hyra tjera vjetore, gjyqtari Sylejmani ka deklaruar 31,980.51 euro nga paga, 1,273.95 euro nga kompensimet për trajnime në Akademinë e Drejtësisë dhe 840 euro të ardhura nga komisionet në KGJK. Bashkë edhe me 497 euro që kishte pranuar nga USAID, del se z. Sylejmani kishte realizuar të hyra vjetore në total prej, 34,590.00 euro. Sa i përket të hyrave të tjera përveç pagës, gjyqtari Sylejmani ka theksuar se të njëjtat kanë qenë pagë, siç është rasti nga PZAP, apo kompensime të tjera nga Akademia e Drejtësisë dhe komisionet në KGJK, por, sipas tij, këto kompensime nuk kanë të bëjnë asgjë me kompensime për udhëtim edhe kompensime tjera që lidhen me to siç i parasheh Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Për më tepër, z. Sylejmani ka theksuar se të gjitha këto funksione ushtrohen gjatë orarit të rregullt të punës si gjyqtar.³⁰

Sa i përket dy funksioneve që z. Sylejmani ushtron në komisione të KGJK-së dhe funksionin e tretë në PZAP, siç edhe është thënë në rastin e gjyqtarëve tjerë në situatë të ngjashme dhe në kapitullin 6.3, ai nuk do duhej të pranonte shpërblime shtesë në rastet kur veprimtaria në këto komisione ushtrohet gjatë orarit të tij të punës. Për dallim nga gjyqtarët tjerë, veprimtaria e z. Sylejmani veçohet pasi që është i vetmi gjyqtar i Supremes që mban tri funksione të tilla në organe të institucioneve. Një gjë e tillë nuk lejohet, konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Aq më pak i lejohet atij të pranojë shpërblime monetare nga të të tri këto funksionet. Përkundër asaj që thuhet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, gjyqtari Sylejmani

³⁰ Intervistë e gjyqtarit Shukri Sylejmani për "Betimi për Drejtësi".

ka insistuar se mbajtja e dy pozitave udhëheqëse nga tri funksionet tjera që i ushtron në total, nuk bie ndesh me këtë Ligj. Sipas tij, pozita e kryesuesit në PZAP është obligim që del nga Ligji për Zgjedhje për gjyqtarët në Supreme, porse, sa i përket kryesuesit në Komisionin në KGJK, gjyqtari e pranon që mund të mos jetë apriori kërkesë ligjore që kryesuesi të vjen nga Gjykata Supreme, por për këtë, i njëjti thekson se është çështje e KGJK-së, caktimi i kryesuesit në këtë komision.³¹ Megjithëse për funksionin e z. Sylejmanit në PZAP nuk ka vërejtje (me përjashtim të shpërblimeve shtesë që merr (shih kapitullin 6.3)) – duke qenë se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton angazhimin e gjyqtarëve në PZAP – janë të papajtueshme funksionet tjera që z. Sylejmani ushtron krahas funksionit të gjyqtarit, konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Përderisa për funksionin në PZAP z. Sylejmanit i lejohet shpërblimi shtesë për aq sa ai funksion kryhet jashtë orarit të tij të punës si gjyqtar (gjë që rëndom nuk ndodhë), për dy funksionet tjera, konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk i lejohet asnjë lloj shpërblimi me përjashtim të kompensimit të shpenzimeve.

Sa i përket shpërblimeve shtesë që z. Sylejmani i merr nga veprimtaria e tij si trajnues në Akademinë e Drejtësisë, vlejné të njëjtat komente të dhëna gjetiu për gjyqtarët trajnues (shih kapitullin 6 dhe komentet për gjyqtarin Agim Maliqi).

ix) Valdete Daka

Kryetarja aktuale e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), znj.Valdete Daka, në deklarimin e saj të pasurisë ka deklaruar të ardhura vjetore nga KQZ dhe nga paga e saj si gjyqtare, shumën prej 40,426,84 euro. Këto të hyra, znj.Daka nuk i ka ndarë sipas shumës, llojit dhe burimit të tyre veç e veç, por i ka deklaruar të gjitha së bashku, duke e privuar publikun nga informacioni i saktë se sa janë të ardhurat që znj.Daka i ka pranuar nga puna e saj si gjyqtare dhe sa janë të ardhurat tjera që i ka realizuar jashtë pagës së saj bazë.

Lidhur me këtë, znj. Daka në një përgjigje për IKD ka thënë se të dy pagat, edhe nga KGJK edhe nga KQZ, i pranon së bashku e jo të ndara njëra nga tjetra. Pagën primare, znj. Daka ka thënë se e merr si gjyqtare në Gjykatën Supreme, kurse, si kryetare e KQZ-së pranon pagë sekondare.

Për dallim nga shumë gjyqtarë tjerë, funksioni i znj. Daka si Kryesuese e KQZ-së si organ jashtë gjyqësorit është i pajtueshëm të ushtrohet përnjëherësh me funksionin e gjyqtarit, duke qenë se i njëjti është edhe kategori kushtetuese (shih edhe kapitullin 6.2). Mirëpo, për aq sa znj. Daka pranon shpërblime shtesë për punën në KQZ gjatë

³¹ Intervistë e gjyqtarit Shukri Sylejmani për emisionin “Betimi për Drejtësi”.

orarit që supozohet të jetë i rregullt për punën si gjyqtare në Supreme, vlerësojmë se të njëjtat shtesa do ishin të palejueshme (shih kapitullin 6.3).

x) Hasim Sogojeva

Gjyqtari Hasim Sogojeva, në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte deklaruar se krahas punës së tij si gjyqtar, është i angazhuar edhe si trajnues në Akademinë e Drejtësisë. Si pagë vjetore nga puna e tij si gjyqtar, z. Sogojeva kishte deklaruar 21,572.00 euro, pagë e cila kishte qenë në kohën kur i njëjti kishte ushtruar këtë pozitë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Kurse, si mëditje nga Akademia e Drejtësisë, gjyqtari Sogojeva kishte deklaruar të hyra 996.07 euro. Sa i përket shpërblimeve shtesë që z. Sogojeva i merr nga veprimtaria e tij si trajnues në Akademinë e Drejtësisë, vlejné të njëjtat komente të dhëna gjetiu për gjyqtarët trajnues (shih kapitullin 6 dhe komentet për gjyqtarin Agim Maliqi).

xi) Gjyqtarët tjerë

IKD ka analizuar edhe deklarimet e pasurisë të gjyqtarëve tjerë në Gjykatën Supreme. Ngjashëm sikurse me gjyqtarët e lartcekur, edhe tek gjyqtarët e tjerë është vërejtur deklarim i pasurisë që nuk përputhet me kërkesat e Ligjit për Deklarimit të Pasurisë, sikurse që është deklarim i të hyrave, të ndara sipas shumës, llojit dhe burimit të tyre. Një deklarim i tillë, ku të hyrat nga pagat, kompensimet, shtesat dhe mëditjet e tjera janë pasqyruar të gjitha së bashku, pa i ndarë ato veç e veç, është hasur tek gjyqtarët, Erdogan Haxhibeqiri, Rasim Rasimi dhe Manushe Karaqi.

Lidhur me shtesat që kishte marrë nga KGJK, gjyqtarja Karaqi ka thënë se i ka pranuar duke u bazuar në vendimet e KGJK-së, kurse, gjyqtari Rasimi, që është edhe kryesues i Panelit për Lirim me Kusht dhe trajnues në Akademi të Drejtësisë, ka thënë se shtesat i kishte pranuar duke u bazuar në vendimet e KGJK-së dhe Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.³² Ndërsa, gjyqtari Haxhibeqiri ka thënë për IKD, se të hyrat i ka deklaruar së bashku pasi sipas tij, edhe në raportin e pagesave të KGJK-së, paga dhe shtesat tjera për komisione figurojnë të pa ndara njëra nga tjetra.³³

Nga 31 gjyqtarët e Supremes, duke përfshirë këtu edhe ata në Dhomën e Posaçme, IKD ka gjetur se 16 gjyqtarë kishin deklaruar si të ardhura vetëm pagat e tyre, kurse shtesat tjera që kishin deklaruar kishin qenë në shuma të vogla, çka lë të nënkuptohet se të njëjtat kanë mundur të jenë kompensime për udhëtime dhe kompensime që lidhen me to, e si të tilla, të lejuara edhe sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

³² Përgjigje të pranuar nga znj. Karaqi dhe z. Rasimi për IKD. 22 shkurt 2021.

³³ Përgjigje e pranuar nga z. Haxhibeqiri për IKD. 18 shkurt 2021.

7.1 Avancimet e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme

Përveç kriterëve minimale të caktuara me ligj për të ushtruar pozitën e gjyqtarit, për të ushtruar këtë pozitë në Gjykatën Supreme kërkohet edhe përvoja e punës si gjyqtar prej tetë (8) viteve.³⁴

Krahas kriterëve formale të përcaktuara me Ligjin për Gjykatat, me Ligjin për KGJK përcaktohen edhe kriterë tjerë që duhet të plotësohen për avancim, ku ndër të tjera përfshihen, njohurinë profesionale, përvojën e punës dhe performancën, përfshirë njohuritë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, aftësinë profesionale, bazuar në rezultatin e punës gjatë periudhës së vlerësimit, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca, aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe më përgjegjësi, sjelljen jashtë zyrës dhe integritetit personal dhe të tjera.

Por, jo gjithmonë kriteret e përcaktuara ligjore për avancim, sikurse integriteti, janë marrë për bazë nga Këshilli Gjyqësor me rastin e propozimeve të tyre për avancim të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme.

KGJK kishte propozuar për tu avancuar në Gjykatën Supreme edhe gjyqtarin Asllan Krasniqi, i cili pastaj edhe ishte dekretuar nga ana e Presidentit të Republikës. Ky i fundit, që tashmë është pjesë e Gjykatës Supreme, ka qenë i akuzuar në të kaluarën për veprën penale të vjedhjes. Për këtë propozim akuzë që ishte ngritur ndaj tij nga ana e Prokurorisë Komonale të Prizrenit, Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 24 maj 2013 kishte nxjerrë aktgjykim refuzues për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit relativ.³⁵

Një tjetër propozim për dekretim që kishte shkuar nga KGJK në Presidencë, për avancim në Gjykatën Supreme kishte qenë edhe ai i gjyqtarit Lekë Prenaj. Ky i fundit, në atë kohë kishte qenë duke u hetuar për përfshirje në një aferë korruptive. Propozimi i KGJK-së për dekretimin e gjyqtarit Prenaj në Gjykatën Supreme nuk kishte kaluar pasi i njëjti nuk ishte dekretuar nga Presidenti.³⁶ Pak muaj më vonë, ndaj z.Prenaj ishte ngritur aktakuzë për korrupsion.³⁷

³⁴ Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat. Neni 32.1.1.4

³⁵ Gjykata Themelore në Gjakovë, dega Malishevë. Aktvendimi P.nr.108/08. Datë, 24.05.2013.

³⁶ "Presidenti nuk e nënshkruan avancimin e gjyqtarit që nxori vendimin për tjetërsimin e pronës milionëshe të RTP-së". Koha.net. 9 janar 2020 (Shih linkun: <https://ëëë.koha.net/arberi/202841/presidenti-nuk-e-nenshkruan-avancimin-e-gjyqtarit-qe-nxori-vendimin-per-tjetersimin-e-prones-milioneshe-te-rtp-se/>) Qasur për herën e fundit më 17 shkurt 2021.

³⁷ "Për tjetërsimin e pronës milionëshe të RTP-së prokuroria ngritë aktakuzë ndaj gjykatësit Lekë Prenaj, Hilmi Kastratit, Shpëtim Pllanës dhe Shkumbin Qehajës". Betimi për Drejtësi. 30 tetor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-tjetersimin-e-prones-milioneshe-te-rtp-se-prokuroria-ngrite-aktakuzen-ndaj-gjyqatesit-leke-prenaj-hilmi-kastratit-shpetim-pllanes-dhe-shkumbin-qehajes/>) Qasur për herën e fundit më 17 shkurt 2021.

Njëherit, disa gjyqtarë të Supremes janë avancuar në Supreme direkt nga Gjykata Themelore, duke i mposhtur kështu në konkurs kolegët e tyre nga instancat më të larta gjyqësore sesa ato e para. Kështu është rasti me gjyqtarët Agim Maliqi (2018), Hamdi Ibrahim (2019), Hasim Sogojeva (2019) dhe Asllan Krasniqi (2019). Në vlerësojmë që avancimi i tyre direkt nga Themeloria në Supreme, duke u favorizuar kundrejt gjyqtarëve të Apelit, lë shije të hidhur në profesionalizmin dhe integritetin e supozuar të sistemit gjyqësor në Kosovë, megjithëse ligjrisht (formalisht) avancimi ishte në rregull.

Lidhur me këto avancime, kryetari i Gjykatës së Apelit, z. Hasan Shala, ndonëse e pranon se përderisa ligjrisht avancimet nga shkalla e parë e gjyqësorit në shkallën e tretë janë në rregull dhe si të tilla nuk mund të quhen se e cenojnë integritetin e sistemit, i njëjti e pranon se më e logjikshme dhe e shëndosh do të ishte nëse do të ishin gjyqtarët e Apelit ata që do të avancoheshin në Gjykatën Supreme.

“Gjithsesi, për shumë arsye kryesisht të natyrës praktike, do të ishte me logjike dhe më e shëndosh për sistemin e drejtësisë, që gjithmonë të avancohen gjyqtarët e apelit, në Gjykatën Supreme. Përjashtim nga ky rregull, do të mund të bëhej vetëm në rast të mungesës së mirëfilltë të konkurrencës, ose ndonjë rrethanë tjetër tepër specifike” – thuhet në një përgjigje për IKD, nga kryetari Shala.³⁸

8. Dështimi i AKK-së në zbatimin e ligjit për deklarim të pasurisë

Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, ka përcaktuar dispozita të qarta lidhur me mënyrën se si zyrtarët publikë duhet të deklarojnë pasurinë e tyre.

Në nenin 3.2 të ligjit të lartcekur, është përcaktuar decidivisht mënyra se si zyrtarët duhet të deklarojnë pasurinë, ku thuhet se: *“Në deklaratën për pasurinë e të ardhurave dhe detyrimeve financiare, zyrtari i lartë publik cek **SHUMËN, LLOJIN DHE BURIMIN E SECILËS TË ARDHUR**, shumën dhe llojin e detyrimeve financiare duke përfshirë edhe emrin e kreditorit si person fizik apo juridik, ndërsa publikimi i emrit të kreditorit bëhet vetëm për personat juridik”.*

Por, përkundër se sipas kësaj dispozite është qartësuar fakti se zyrtarët publik duhet të deklarojnë secilën të hyrë të tyre, sipas **shumës, llojit** dhe **burimit** të tyre, në praktikë, shumë zyrtarë të hyrat e tyre i deklarojnë në kundërshtim me kërkesat ligjore.

E kësaj siç duket i ka kontribuar edhe vet Agjencia Kundër Korrupsion, institucion ku zyrtarët e lartë deklarojnë pasurinë e tyre. Sipas AKK-së, Ligji për Deklarimin e pasurisë nuk kërkon në mënyrë specifike që këto të hyra të deklarohen veç e veç.

³⁸ Përgjigje nga z. Shala për IKD. 4 mars 2021.

“Ligji për deklarim të pasurisë Nr. 04/L-228, nuk specifikon llojin e lartësinë, apo të të hyrat e ndara veç e veç por thekson: të ardhurat personale për vitin kalendarik nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale”, thuhet në një përgjigje për IKD nga AKK.³⁹

Në këtë rast, AKK nuk e përmend fare se në ligjin bazik për deklarimin e pasurisë, konkretisht, nenin 5.3 është përcaktuar qartë se zyrtari i lartë publik cek shumë, llojin dhe burimin e secilës të ardhur. I njëjti nen, edhe në plotësim/ndryshimin e Ligjit për Deklarimin e Pasurisë, të cilit i referohet AKK, ka mbetur i pandryshuar.

Madje, përgjigja e AKK-së bëhet edhe më konfuze, pasi që në pyetjen se a kanë pranuar deklarime të pasurisë nga ana e zyrtarëve publik të cilat të hyrat e tyre i kanë deklaruar të gjitha së bashku pa i ndarë të njëjtat secilën veç e veç, sipas shumë, llojit dhe burimit të tyre, AKK përgjigjet duke thënë se *“Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar raste të tilla kur zyrtarët publik të hyrat e tyre i kanë deklaruar të gjitha së bashku dhe për të njëjtat ka kërkuar plotësimin e formularëve sikurse parashihet me ligj”,* çka len të nënkuptohet se deklarim i të ardhurave të gjitha së bashku nuk është konform ligjit.⁴⁰








Përkundër kësaj përgjigje nga AKK, siç u pa edhe më lartë nga deklaratimet e pasurisë së gjyqtarëve, një pjesë e madhe e tyre, të hyrat e tyre i kanë deklaruar jo duke i ndarë sipas shumë, llojit e burimit të tyre por të gjitha bashkë. Një deklarim i tillë, e bënë të pamundur identifikimin e secilës të hyrë të zyrtarëve, llojit të tyre dhe burimit. Përkundër deklaratimit të tillë, Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) i ka pranuar formularët si ti tillë, edhe pse qartazi të njëjtit nuk kanë qenë të përpiluar sipas kërkesave ligjore të lartcekura.

Gjithashtu, probleme tjera që vërehen edhe me transparencën e AKK-së kur vjen fjala të deklarimi i pasurisë, pasi që, formularë të deklarimit të pasurisë, sikurse ai i gjyqtari Beshir Islami fare nuk gjenden në faqen zyrtare të AKK-së, përkundër se emri i të njëjtit gjendet tek lista e zyrtarëve që kanë deklaruar pasurinë. Gjithashtu, ka një numër të formularëve të zyrtarëve, të cilët përkundër se figurojnë në faqen zyrtare të AKK-së, të njëjtit formularë nuk hapen. Krejt këto lëshime bëhet nga vet AKK, si autoritet të cilës i përgjigjen zyrtarët për deklarim të pasurisë dhe e cila ka kompetenca edhe për iniciimin e procedurave ndaj zyrtarëve që bien ndesh me ligjin për deklarimin e pasurisë. Lidhur me këtë, nga AKK thonë se janë lëshime teknike.

³⁹ Përgjigje përmes adresës elektronike nga Agjencia Kundër Korrupsion. 24 shkurt 2021.

⁴⁰ Po aty.

PAGAT DHE KOMPENSIMET E GJYKATËSVE NË GJYKATË SUPREME

Gjykatësit	Paga bazë sipas ligjit	Paga e deklaruar	Shtesat e deklaruar	Veprimtaritë profesionale	Totali vjetor i të hyrave	Deklarimi sipas ligjit
 Enver PEÇI	35,400 €	35,585 €	7,400 €	835 €	43,820 €	✓
 Agim MALIQI	31,860 ¹ €	32,826 €	1,410 €	100 €	34,336 €	X
 Albert ZOGAJ	28,668 ² €	26,303 €	6,935 €	5,472 €	38,710 €	X
 Fejzullah REXHEPI	28,668 ³ €	26,538 €	7,159 €	0 €	33,697 €	✓
 Gyltene SYLEJMANI	31,860 ² €	39,488 €	6,778 €	0 €	46,266 €	X
 Nebojša BORIČIĆ	31,860 €	31,152 €	3,777 €	450 €	35,379 €	✓
 Nesrin LUSHTA	31,860 €	33,480 €	4,694 €	0 €	38,174 €	X

SHUMË GJYKATËS NUK E KANË DEKLARUAR PAGËN BAZË DHE TË HYRAT E TJERA SIPAS OBLIGIMIT LIGJOR.

“Gjyqtarët, për aktivitetet e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim Gjyqtarët e njoftojnë Kryetarin e Gjykatës kurse Kryetarët e Gjykatave e njoftojnë Këshillin.”








LIGJI PËR GJYKATAT

“Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”

LIGJI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

- 1 Gjykatësi Agim Maliqi në deklarimin e tij, tek pagat ka përfshirë edhe të ardhurat nga mëditjet dhe shtesat, duke mos i ndarë ato veç e veç.
- 2 Gjykatësi Albert Zogaj në deklarimin e tij, të ardhurat nga mëditjet dhe shtesat, nuk i ka ndarë ato veç e veç, sipas llojit dhe burimit. Në vitin 2019, Zogaj kishte qenë gjyqtar në Apel dhe paga bazë e tij kishte qenë 28,668 euro.
- 3 Në vitin 2019, gjykatësi Fejzullah Rexhepi kishte qenë gjyqtar në Apel dhe paga bazë e tij kishte qenë 28,668 euro.
- 4 Gjykatësja Gyltene Sylejmani në deklarimin e saj, tek pagat ka përfshirë edhe të ardhurat nga komisionet, duke mos i ndarë ato veç e veç.
- 5 Gjykatësja Nesrin Lushta në deklarimin e saj, tek pagat ka përfshirë edhe të ardhurat nga komisionet, duke mos i ndarë ato veç e veç.

PAGAT DHE KOMPENSIMET E GJYKATËSVE NË GJYKATË SUPREME

Gjykatësit	Paga bazë sipas ligjit	Paga e deklaruar	Shtesat e deklaruar	Veprimtaritë profesionale	Totali vjetor i të hyrave	Deklarimi sipas ligjit
 Shukri SYLEJMANI	31,860 €	31,980 €	2,113 €	497 €	34,590 €	✓
 Valdete DAKA	31,860 ⁶ €	40,426 €	0 €	0 €	40,426 €	X
 Hasim SOGOJEVA	20,064 ⁷ €	21,572 €	996 €	0 €	22,568 €	✓
 Manushe KARAÇI	31,860 ⁸ €	30,511 €	0 €	0 €	30,511 €	X
 Sabri HALILI	31,860 €	34,198 €	0 €	0 €	34,198 €	✓
 Rasim RASIMI	31,860 ⁹ €	36,650 €	0 €	0 €	36,650 €	✓
 Erdoogan HAXHIBEQIRI	31,860 ¹⁰ €	33,809 €	0 €	1,290 €	35,018 €	X

SHUMË GJYKATËS NUK E KANË DEKLARUAR PAGËN BAZË DHE TË HYRAT E TJERA SIPAS OBLIGIMIT LIGJOR.

"Gjyqtarët, për aktivitetet e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim Gjyqtarët e njoftojnë Kryetarin e Gjykatës kurse Kryetarët e Gjykatave e njoftojnë Këshillin."

LIGJI PËR GJYKATAT

"Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të."

LIGJI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

6 Gjykatësja Valdete Daka në deklarimin e saj, ka deklaruar të ardhurat pa i ndarë ato veç e veç, sipas llojit dhe burimit.

7 Në vitin 2019, gjykatësi Hasim Sogojeva kishte qenë gjykatës në Gjykatës Themelore dhe paga bazë e tij kishte qenë 20,064 euro.

8 Gjykatësja Manushe Karaçi në deklarimin e saj, tek pagat ka përfshirë edhe të ardhurat nga komisionet, duke mos i ndarë ato veç e veç.

9 Gjykatësi Rasim Rasimi në deklarimin e tij, ka deklaruar të ardhurat pa i ndarë ato veç e veç, sipas llojit dhe burimit.

10 Gjykatësi Erdoogan Haxhibeqiri në deklarimin e tij, tek pagat ka përfshirë edhe të ardhurat nga komisionet, duke mos i ndarë ato veç e veç.

9. Rekomandime

- Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë plotësim/ndryshimit të kornizës ligjore, të sigurohet që e njëjta të jetë në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Kosovës, përkatësisht me dispozitat kushtetuese ku kërkohet që **gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit**, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me obligimet kushtetuese, të sigurohet që gjyqtarët të mos caktohen në mekanizma shtetërorë të cilët cenojnë integritetin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me obligimet që dalin nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, të sigurohet që gjyqtarët të mos marrin kompensime shtesë gjatë orarit të punës, dhe në raste kur kjo nuk zbatohet mekanizmat e sistemit gjyqësor të iniciojnë procedura disiplinore ndaj gjyqtarëve;
- Gjyqtarët e Gjykatës Supreme konform dispozitave ligjore, të mos marrin shpërblime shtesë për punët që kryejnë gjatë orarit të rregullt të punës si gjyqtarë, përveç kompensimeve për udhëtim dhe kompensimeve që lidhen me to;
- KGJK të bëjë plotësim/ndryshimet në legjislacionin e saj sekondar ashtu që të ndalojë pagesat shtesë për angazhimin e gjyqtarëve në komisione gjatë orarit të rregullt të punës, në mënyrë që të harmonizohen këto rregulla të brendshme me kornizën ligjore e kushtetuese në Kosovë;
- KGJK, nëse e sheh të nevojshme, angazhimet shtesë të gjyqtarëve në komisione t'i kompensojë në kuptim të zvogëlimit të normës së kryerjeve të lëndës për kohën sa gjyqtarët kanë qenë të angazhuar në komisione apo veprimtari të ngjashme, por jo me pagesa shtesë;
- KGJK të mos propozojë për avancim gjyqtarë me integritet të kontestuar;
- Agjencia Kundër Korrupsion në mënyrë proaktive të zbatojë mandatin ligjor në iniciimin e procedurave ndaj gjyqtarëve që shkelin Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik;
- Agjencia Kundër Korrupsion të mos pranojë si të rregullta formularët për deklaram të pasurisë që nuk janë konform ligjit për deklarimin e pasurisë;
- Agjencia Kundër Korrupsion të publikojë të gjitha formularët e deklaramit të pasurisë të gjyqtarëve dhe zyrtarëve tjerë dhe të kujdeset që të njëjtit formular të jenë të qashtëm për publikun;
- Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të tyre të mbaj llogaridhënës AKK-në, lidhur me zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.